

RREGULLORJA E BRENDSHME E EFIP

Kjo rregullore e brendshme ka për qëllim të sigurojë funksionimin e duhur dhe sigurinë e nxënësve dhe të personelit .

Shkolla është një vend i përkushtuar për arsimin dhe mësimdhënje. Këto rregulla janë të dizajnuara për të zbatuar, në kushtet më të mira, mësimin e jetës, njohuritë për jetën në komunitet, ndjenjën e përgjegjësisë, të drejtat dhe detyrat e të gjithëve akterëve të përfshirë në komunitetin shkollor.

EFIP bazohet në parimet e mëposhtme:

- Cilësia e mësimdhënies
- Respektimi i neutralitetit politik, ideologjik apo fetar (parimi i laicitetit).
- Detyra për të respektuar të tjerët.
- Mbrojtjen e garantuar kundër çdo abuzimi fizik ose mendor dhe detyrën secilit për të mos përdorur dhunë dhe për të dënuar përdorimin e saj
- Obligimi për nxënësit për të marrur pjesë në të gjitha aktivitetet e parapara për orarin dhe obligative në kurrikulen zyrtare.
- Respektimi i orarit HYRJET /DALJET

STRUKTURA DHE FUNKSIONIMI PEDAGOGJIK

Struktura arsimore dhe funksionimi i Shkollës franceze ndërkombëtare të Prishtinës korrespondojnë me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit francez. Bazohen me tekstet zyrtare të botuara në Fletoren Zyrtare. Personeli mësimdhënës mund të bëjë ndonjë ndryshim për të arritur përputhshmërinë me dekrete të botuara.

Një arsimim i përshtatur në gjuhë zyrtare iu ofrohet çdo nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë. në përputhje me udhëzimet e MASHT (për nxënësit e të gjitha kombësive).

ORGANIZIMI I VITIT SHKOLLOR

• Kalendari shkollor

Kalendari shkollor elaborohet çdo vit. Miratohet nga komiteti menaxhues i Scolae Mundi , AEFÉ dhe ambasadës.

Përshatshmëri mund të bëhen duke marrur në konsideratë ditët e festave zyrtare të vendit pritës dhe festat lokale.

Vëllimi i orëve të punës do të mbetet i barabartë me numrin i orëve mësimore në Francë. Dmth 24 orë mësimi dhe 2 orë të mësimi të gjuhës lokale

Kalendari shkollor miratohet në fund të vitit shkollor për vitin e ardhshëm, gjatë një mbledhje të Këshillit të shkollës.

Drejtori i institucionit ka lirinë të përshtatet me vendimet e Ministrive të vendit pritës për të mbyllur objektin në qoftë se kushtet e sigurisë nuk janë përmbushura.

Orari shkollor

Orari i ciklit 1 (kopshti):

8h30 - 12h dhe 13h30 – 15h30, të hënave, të marteve, të mërkurave, të enjteve

8h30 - 12h30, të premteve

Orari i ciklit 2 (klasa e parë, e dytë dhe e tretë) :

8h30 - 12h00 dhe 13h30 – 15h30, të hënave, të marteve, të mërkurave, të enjteve

8h30 - 12h30, të premteve

Orari i ciklit 3, klasa e 4 dhe 5 :

8h30 - 12h dhe 13h30 - 15h30, të hënave, të marteve, të mërkurave, të enjteve

8h30 - 12h30, të premteve

Edhe nxënësit e CNED iu përshtaten këtij orari

Pritja e nxënësve

Është i obligueshëm respektimi i orarit në vijim

Për nxënësit e kopshtit të fëmijëve, pritja bëhet në klasë mes 8h20 dhe 8h30 .Në mbrëmje, fëmijët iu dorëzohen prindërve tek porta e hyrjes së shkollës në orën 15 e 30 dhe në 12h30 të premteve (ose në 13h nëse fëmija drekon në mensë)

Për fëmijët e klasës së parë deri në klasën e 5, pritja bëhet në korridorin e shkollës në mes të 8h20 dhe 8h30.Në mbrëmje, fëmijët shoqërohen deri tek porta e shkollës në orën 15h30 dhe 12h30 të premteve(ose 13h nëse fëmija drekon në mensë)

Nxënësit e kolegjit mirëprehen në oborr prej 8h20 - 8h30. Ata zbresin në oborr pas mësimeve.

Portat e shkollës mbyllet në orën 8 h40.Çdo vonesë duhet të arsyetohet.

Para kohës zyrtare të hyrjes (8h20) dhe pas kohës së daljes, fëmijët janë përgjegjësi e prindërve të tyre (apo e transportuesit). Nëse një nxënës duhet të lërë shkollën gjatë orëve të mësimit, mund të bëjë këtë vetëm duke qenë i shoqëruar : një fëmijë vetëm nuk mund të largohet nga shkolla gjatë orëve të mësimit.

Komunikimi mes prindërve dhe mësuesve

Mësuesit dhe drejtori i shkollës janë në dispozicion me termine, jashtë orarit mësimor, për të pritur prindërit që dëshirojnë të takohen me ta. Informatat do të përcillen me email.

Një mbledhje në çdo fillim vit mbahet në çdo klasë gjatë gjysmës së parë të shtatorit.Në fillim të çdo viti shkollor, shkolla organizon zgjedhjen e përfaqësuesve të prindërve, të cilët pastaj do të jenë pjesë e Këshillit të shkollës. Prindërit e zgjedhur janë një mundësi shtesë e informacionit dhe shkëmbimit në mes prindërve dhe shkollës. Roli i tyre është thelbësor në dëgjimin e prindërve, në sigurimin e kontaktit të përhershëm me drejtorin e shkollës dhe mësuesit dhe janë zëdhënësit dhe përfaqësuesit e të gjithë prindërve.

Këshilli i shkollës mblidhet tre herë në vit.Procesverbali i aprovuar iu komunikohet të gjitha familjeve në mënyrë elektronike .

Vlerësimi i aftësive

Nxënësit vlerësohen në aspektin e aftësive disiplinore dhe diturive. Një librezë e vlerësimit periodik të shkathtësive për këtë qëllim bëhet semestër. Kjo librezë është e njëjtë për të gjithë ciklin. Iu jepet familjeve për nënshkrim në çdo vlerësim tremujor ose përfundimtar. Ajo duhet patjetër të kthehet në shkollë dhe t'i bashkëngjitet dosjes së shkollës.

Jeta shkollore

Gjatë pranisë së tyre në EFIP, nxënësit janë nën përgjegjësinë e personelit të institucionit. Gjatë orëve të mësimit, çdo mësues është përgjegjës për nxënësit në klasë. Gjatë pushimeve, përgjegjësia qëndron te mësuesit kujdestarë. Megjithatë, çdo mësues, mbikqyrës apo mbikëqyrësit duhet të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre si edukatorë, nëse janë dëshmitarë të sjelljes jo të mirë të një nxënësi apo grupi nxënësish apo situatë që duket atyreve e rrezikshme.

Institucioni duhet të sigurojë të gjithëve mundësinë për të punuar me rregull dhe në qetësi; ekipi pedagogjik zbaton të gjitha masat e nevojshme për respektimin e këtyre kushteve. Çdo incident i rëndë apo i përsëritur do tu komunikohet prindërve dhe nëse duhet do të merren sanksione të vendosuar nga ekipi pedagogjik.

Vijueshmëria

Shkolla është e obligueshme për të gjithë nxënësit. Thirrja e nxënësve bëhet çdo ditë. Mungesat duhet të jenë të rralla dhe për arsye shëndeti apo familjare. Prindërit duhet ta njoftojnë menjëherë shkollën me email ose me telefon. Çdo mungesë duhet të arsyetohet me shkrim, që duhet të nënshkruhet nga prindërit ku tregojnë arsyet e mungesës.

Në rast të sëmundjeve ngjitëse, një certifikatë mjekësore që dëshmon që nxënësi nuk është më infektues për të tjerët në klasë është e obligueshme për riintegrimin e tij në klasë

Kalendari i pushimeve shkollore duhet të respektohet. Çdo pushim i paraparë apo i zgjatur duhet të bëhet me marreveshjen me drejtorin

Shetitjet shkollore dhe klasat studimore.

Gjatë vitit shkollor organizon shetitje shkollore dhe klasa studimore jashtë shkollës në kuadër të projektit shkollor, në iniciative të mësuesve dhe në pajim me familjet. Pagesat për këto aktivitete mund t'i takojnë plotësisht ose pjesërisht prindërve. Pjesëmarrja financiare nga familjet mund të kërkohet para organizimit të aktivitetit.

Ekipi pedagogjik i informon prindërit në lidhje me detajet e shetitjeve shkollore (orari, vendi, pjesëmarrjen në financim...). Mund tu kërkohet prindërve që të marrin pjesë në këto dalje për të ndihmuar mbikqyrjen e nxënësve. Drejtori i shkollës është përgjegjës për respektimin e rregullave të sigurisë dhe ka të drejtën e anulimit të Çdo dalje që nuk i plotëson kushtet e domosdoshme nga rregullat dhe ligjet në fuqi

Materiali

Çantat e nxënësve dhe futrolla i takojnë familjeve për t'i blerë .Materiali që ato përmbajnë (ngjyrat, fillmasterat, lapsat, kimikat, gomat...) furnizohen nga shkolla. , në rast të humbjes ose prishjes i takon familjebe t'i riblejne.Nxënësit e kolegjit nuk duhet ta harrojnë materialine tyre.Çdo harresë do tu përkujtohet prindërve. Prindërit duhet të mbikqyrin femijet që të kenë kujdes për librat dhe fletoret. Prinërit duhet të mbikqyrin fëmijët për mirëmbajtjen e librave dhe fletoreve.

Mensa shkollore

Në mensën e shkollës shërbehen gjella të ngrohta vetëm në drekë. Nxënësit që duan mund të sjellin me vete ushqimin që do të ngrohet pastaj në kuzhinë. Nxënësit mund të sjellin një zamër për pushimin paraditës.

Dreka është prej orës 12h deri në 13h .Për çmimore të konsultohet rregullorja financiare

Gjatë pauzës së drekës, fëmijët janë nën përgjegjësinë e të rriturve që mbikqyrin menzen. Rregullat e mirësjelljes duhet praktikohen gjatë gjithë kohës.

Aktivitetet gjatë orarit mësimor

Aktivitetet do të organizohen duhet të autorizohen paraprakisht nga drejtori. Këto aktivitete janë vetem per nxenesit e regjistruar në shkollën franceze.

Siguria

Hyrjet dhe daljet (në ose nga klasa) bëhen në qetësi dhe në rresht. Asnjë nxënës nuk duhet të qëndrojë në klasë pa praninë e ndonjë të rrituri. Gjatë pushimeve , dhuna, shtyerjet dhe lojërat e rrezikshme janë të ndaluara.Është e ndaluar sjellja në shkollë e ndonjë mjeti ose produkti që mund të jetë i rrezikshëm. Prindërit janë përgjegjës për materialin që nxënësit sjellin dhe se cilat pajisje duhet të kufizohet me nevojat e përcaktuara të mësimi. Cdo mjet që do të vinte në rrezik jetën e tjetrit do të jetë përgjesësi e pronarit. Nuk këshillohen të barten bizhuteri dhe në përgjithësi cdo gjë me vlerë, shkolla nuk do të jtë përgjegjëse në rast të humbjes, vjedhjes apo dëmtimit. Çdo dëmtim I shkaktuar nga një nxënës do të faturohet familja e tij. Veshjet duhet të jenë korrekte dhe në përputhje me kërkesat e praktikës shkollore. Makiashi dhe sandalet-shapkat janë rreptesisht te ndaluara

Telefonat mobil dhe pajisjet e tjera elektronike duhet të fiken brenda shkollës. Lidhur me nxënësit e fillores, vetëm telefonat e shkollës do të përdoren për komunikim fëmijë / familjes gjatë orëve të mësimi.

Sigurimi individual në shkollë është i detyrueshëm për vitin shkollor aktual, një certifikatë/dëshmi duhet të sjellet në institucionin.

Në rast aksidenti ose sëmundjeje, prindërit njoftohen menjëherë me telefon. Shkolla, do ta thërret Shërbimin mjekësor emergjent, kur aksidenti është i rëndë dhe / ose me komplikime.

Prindërit janë përgjegjës për ndonjë fatkeqësi në rrugën nga shtëpia në shkollë (dhe anasjelltas), Me përjashtim të transportit të bërë nga kombi/ veturat e shkollave dhe të kontraktuaranga shkolla. Po kështu, përgjegjësia civile është përgjegjësi e tyre për çdo dëm që rezulton nga dështimi për të respektuar këto rregulla.

Siguria ndaj zjarrit / fatkeqësive natyrore është organizuar . Dy stërvitje simulimi do të zhvillohen gjatë vitit shkollor. Plani i evakuimit do të afishohet në shkollë dhe, përveç ushtrimeve të përmendura më lart, organizohet dhe një sesion ndërgjegjësimi në klasë (sjelljet që duhet përshtatur, sinjale zanore, shenjat, largimi) kjo do të përshtatet për ato më të vegjëlit.

Shkolla ka hartuar gjithashtu edhe planin e vecante per siguri që është miratuar nga ambasada e Francës në Kosovë dhe nga inspektori I regjionit.

Siguria ndaj ndërhyrjeve është organizuar . Dy stërvitje simulimi do të zhvillohen gjatë vitit shkollor. Plani i evakuimit do të afishohet në shkollë dhe, përveç ushtrimeve të përmendura më lart, organizohet dhe një sesion ndërgjegjësimi në klasë (sjelljet që duhet përshtatur, sinjale zanore, shenjat, largimi)kjo do të përshtatet për ato më të vegjëlit.

HIGJIENA

Pritet që nxënësit të kujdesen, nën kontrollin e personelit të shkollës, për mbajtjen e pastërtisë së përgjithshme të lokaleve brenda dhe jashtë institucionit.

Furnizimi me sapun dhe letra higjenike nga ana e shkollës mundëson sigurinë e higjienës së fëmijëve. Kërkohet nga nxënësit të përdorin këto në mënyrë të përshtatshme, të mos i dëmtojnë dhe të mos abuzojnë me përdorimin e peshqirave për tharje të duarve.

Çdo alergji (në ushqim apo produkt pastrimi...) duhet të raportohet në fillim të vitit shkollor në formularin e informatave për këtë qëllim.Gjithashtu prindërit duhet të njoftojnë shkollën për cdo ndryshim të mundshëm

KLASA E KOPSHTIT:

Fëmijët e moshës 2-4 vjet, (si dhe fëmijët e 5 vjeçares ku prindërit na kanë informuar paraparkisht për nevoja të veçanta) janë të shoqëruar nga një i rritur në tualet.

* Pjesa tjetër e fëmijëve 5 vjeçarë, që janë autonomë, mund të shkojnë në tualet nën mbikëqyrjen e një të rrituri prej klasës në tualet dhe prej tualetit në klasë.

* Nëse është e nevojshme, fëmijët do të ju ndërrohen rrobat nga asistentja mundësisht me rroba të tyre.

* Mësuesit dhe mbikëqyrësit sigurojnë që fëmijët të marrin zamrën dhe drekën në kushte të kënaqshme të higjienës dhe në qetësi.

SHPËRNDARJA E RREGULLORES SË BRENDSHME

Kjo rregullore do të miratohet nga Bordi I shkollës gjatë tremujorit të parë Do të ju jepet familjevepër informatë dhe do të afishohet në korridor.

Ajo i jepet dhe komunikohet çdo të rriturit të përfshirë në edukimin e fëmijëve.

Prindërit duhet të sjellin mbështetjen e tyre aktive në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje duke rekomanduar fëmijët e tyre për të vëzhguar kërkesat, duke siguruar pjesëmarrjen në punën e shkollës, në faktorët e suksesit shkollor. Kjo rregullore do të lexohet dhe të diskutohet në klasë, po aq shpesh që të jetë e nevojshme

miratuar nga Këshilli I shkollës me 17. prill 2018